

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE PËR EKSPERT TË RI JO-KYÇ (ri-njoftim)

Projekti i financuar nga BE-ja “Asistencë Teknike për përmirësimin e mjedisit mundësues për Organizatat e Shoqërisë Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut”

Numri i Identifikimit: EuropeAid/140131/DH/SER/MK

Projekti i financuar nga BE-ja “Asistencë Teknike për përmirësimin e mjedisit mundësues për organizatat e shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut” kërkon një Ekspert të Ri Jo-Kyç për një angazhim specifik për të mbështetur zbatimin e projektit. Projekti synon të mbështesë Qeverinë në përmirësimin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile, si dhe në të njëjtën kohë të ofrojë mbështetje për organizatat e vogla dhe bazë në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive të tyre operacionale të qëndrueshme.

Projekti zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga Corporate & Public Management Consulting International (CPM) përmes dy komponentëve: Komponenti 1A) Mbështetje për zbatimin e objektivave kryesore të Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2022-2024), dhe Komponenti 2A) Mbështetje për zbatimin e objektivave kryesore të Planit të Veprimit Gjinnor III – Plani i Veprimit në Nivel Shtetëror për Maqedoninë e Veriut.

EKSPERT I RI JO-KYÇ PËR MBËSHTETJEN E KËSHILLIT PËR BASHKËPUNIM MIDIS QEVERISË DHE SHOQËRISË CIVILE

Inputet (kontributet): deri në 30 ditë pune nga janari deri më 17 mars 2025

Kualifikime dhe aftësi:

- Diplomë universitare në drejtësi, administratë publike, shkenca politike, shkenca sociale, ekonomi ose ndonjë fushë tjetër që ka lidhje me detyrën
- Aftësi të mira kompjuterike (komandë e Microsoft Office)
- Njohuri të shkëlqyera në shkrim dhe të folur në anglisht, maqedonisht dhe/ose shqip
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe ndërpersonale
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar dhe analitike

Përvoja e përgjithshme profesionale

- Së paku tre (3) vite përvojë pune në fusha të tilla si shoqëria civile dhe/ose të drejtat e njeriut, dhe/ose demokracia, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit.

Përvoja specifike profesionale

- Minimumi tre (3) vite përvojë profesionale në fushën e mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile
- Përvoja dhe njohuritë në politikat e shoqërisë civile dhe qeverisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë përparësi
- Njohuritë mbi mekanizmat e Qeverisë për bashkëpunim me OSHC-të janë përparësi, veçanërisht roli dhe funksioni i Këshillit
- Përvojë pune në të paktën një projekt të financuar nga BE në Republikën e Maqedonisë së Veriut është përparësi.

Përgjegjësitë: Të ofrojë mbështetje për Këshillin për Bashkëpunim me OSHC-të përmes mbështetjes së Ekspertëve Të Lartë Jo-Kyç në të gjitha detyrat përkatëse që kontribuojnë në zbatimin e Aktivitetit 1.3.1 A: Përmirësimi i kuadrit institucional për zhvillimin e shoqërisë civile. Mbështetja përfshin: mbështetje teknike dhe mbështetje të tjera për Ekspertët e Lartë Jo-Kyç dhe Projektin, duke përfshirë organizimin e mbledhjeve online dhe/ose fizike ndërmjet ekspertëve të projektit dhe palëve të interesuara, mbështetje në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme nën udhëheqjen e Ekspertëve Të Lartë Jo-Kyç, mbështetje për aktivitetet e komunikimit dhe çdo mbështetje tjetër të kërkuar.

APLIKIMI

Kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kriteret e mësipërme, duhet të dorëzojnë një CV të formatit BE në gjuhën angleze në recruitment@cpmconsulting.eu dhe stefanovic@cpmconsulting.eu, deri më **20 dhjetor 2024 në orën 16:00 CET**.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtë do të kontaktohen me e-mail. Aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

